

ANKIM

Drejtuar

KOMISIONIT TË ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE (KAS)

Nr. Prot. _____

Tiranë, më ____ / ____ / 2026

ANKUES:

Z. Lefter MALIQI, kandidat për Kryetar të Bashkisë Kuçovë në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, me adresë për njoftime: Rruga "Vaçe Zela", Tiranë.

PALË E INTERESUAR:

Z. Kreshnik HAJDARI, Kryetar aktual i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

AKTI I ANKIMUAR:

Vendimi nr. 46, datë 01.07.2026, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për shqyrtimin administrativ të rezultatit të verifikimit për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë...".

OBJEKTI I ANKIMIT:

1. Pranimin e ankimit si të bazuar në ligj dhe në prova.
2. Shfuqizimin e plotë të vendimit nr. 46, datë 01.07.2026, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Ndryshimin e vendimit dhe konstatimin se z. Kreshnik Riza Hajdari ka paraqitur të dhëna të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në formularin e vetëdeklarimit të depozituar më 02.04.2023, duke mos deklaruar dënimin penal dhe masën e dëbimit nga Republika e Greqisë.
4. Konstatimin se deklarimi i rremë në formularin e dekriminalizimit sjell, sipas ligjit nr. 138/2015 dhe Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi, zgjedhja dhe ushtrimi i funksionit publik.
5. Shpalljen e pavlefshmërisë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, z. Kreshnik Riza Hajdari, si dhe njoftimin e menjëhershëm të

Kryeministrit dhe institucioneve kompetente për vijimin e procedurave ligjore.

6. Në mënyrë alternative, shfuqizimin e vendimit nr. 46/2026 dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim nga KSHZ, me detyra të qarta dhe të detyrueshme për shqyrtimin e pasojave të deklarimit të rremë, të vendimit penal për falsifikimin e formularit, të precedentit Agim Kajmaku dhe të gjendjes juridike në momentin e kandidimit.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1 pika 3, 2, 4, 6/1, 18, 42 dhe 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", veçanërisht nenet 1, 2, 5, 8, 10 dhe 14; Vendimi i Kuvendit nr. 17/2016, veçanërisht Kreu III, pika 3, shkronja "ç", dhe Kreu V; nenet 19, 21, 123, 124/1, 128 e vijues, 137-144 të Kodit Zgjedhor; nenet 7, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 44, 45, 46, 47, 48, 66, 87, 98, 99, 100, 107, 108, 109 dhe 110 të Kodit të Procedurave Administrative, për aq sa zbatohen; neni 190/2 i Kodit Penal; si dhe praktika administrative dhe gjyqësore e cituar në vijim.

DREJTUAR:

Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

I. LEGJITIMIMI DHE AFATI

Ankuesi Lefter Maliqi ka qenë kandidati rival për Kryetar të Bashkisë Kuçovë në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 dhe ka marrë pjesë si palë e interesuar në të gjithë procedurën administrative e gjyqësore të zhvilluar për mandatin e z. Kreshnik Hajdari. Interesi i tij është i drejtpërdrejtë, personal, aktual dhe i ligjshëm, sepse vendimi i ankimuar mban në detyrë kandidatin fitues, kandidimi dhe mandati i të cilit janë kundërshtuar që përpara shtypjes së fletëve të votimit.

Vendimi nr. 46/2026 parashikon shprehimisht të drejtën e ankimit në KAS brenda 30 ditëve nga shpallja. Ky ankim paraqitet brenda afatit ligjor.

II. RRETHANAT FAKTIKE DHE PROCEDURALE

1. Më 02.04.2023, z. Kreshnik Hajdari depozitoi në KQZ formularin e vetëdeklarimit me nr. unik BR-PS-17366, si kandidat i Partisë Socialiste për Kryetar të Bashkisë Kuçovë.
2. Më 04.04.2023, Koalicioni "Bashkë Fitojmë", me shkresën nr. 220, vuri në dijeni KQZ-në se kandidati rezultonte i dënuar penalisht në Republikën e Greqisë dhe se këtë fakt nuk e kishte deklaruar.



3. Dokumentacioni zyrtar i administruar më pas provoi se z. Hajdari ishte dënuar me vendimin penal të formës së prerë nr. 3286/23-6-1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë, si dhe se ishte deportuar në Shqipëri. Në formular ai ishte përgjigjur "JO" ndaj pyetjeve për dënimin dhe dëbimin nga një shtet i huaj.
4. Megjithëse kundërshtimi ishte ngritur përpara zgjedhjeve, KQZ nuk e ndaloi kandidimin. Z. Hajdari u përfshi në fletën e votimit, mori pjesë në zgjedhjet e 14 majit 2023 dhe, me vendimin nr. 679, datë 04.07.2023, mori mandatin e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë.
5. Me vendimin nr. 816, datë 14.11.2023, Komisioneri konstatoi se z. Hajdari nuk përfshihej në kushtet e ndalimit dhe lejoi vazhdimin e mandatit. Me vendimin nr. 1, datë 05.01.2024, KAS e shfuqizoi këtë vendim dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim, për vlerësimin e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative.
6. Ndërkohë, më 18.12.2023 u regjistrua çështja penale ndaj z. Hajdari për veprën penale "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal. Me vendimin nr. 6, datë 25.01.2024, GJKKO e deklaroi fajtor dhe e dënoi përfundimisht me 6 muaj burgim, të zëvendësuar me 150 orë punë në interes publik.
7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe më pas Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstatuan se çështja duhej të përfundonte administrativisht në KQZ, pasi KAS e kishte kthyer për rishqyrtim dhe nuk ekzistonte ende një akt përfundimtar mbi themelin.
8. Më 01.07.2026, Komisioneri nxori vendimin nr. 46, duke e reduktuar çështjen te ekzistenca aktuale e një dënimi penal ndalues dhe duke lejuar vazhdimin e mandatit, me arsyetimin se pas përfundimit të punës në interes publik, dënimi konsiderohet i paqenë sipas nenit 63 të Kodit Penal.

III. SHKAQET E ANKIMIT

1. Komisioneri ka identifikuar gabimisht dhe ka ngushtuar në mënyrë të palejueshme objektin e çështjes

Që në krye të herës, kërkimi i koalicionit opozitar dhe i kandidatit të opozitës z. Lefter MALIQI, nuk ka qenë thjesht konstatimi nëse dënimi grek i vitit 1999 përbënte apo jo një nga ndalimet materiale të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015. Kërkimi kryesor ka qenë moslejimi i kandidimit, mosparaqitja e Hajdarit në fletën e votimit dhe më pas pavlefshmëria e mandatit, sepse kandidati kishte paraqitur një formular të rremë, duke mohuar një dënim dhe një dëbim që kishte detyrimin t'i deklaronte.

Vendimi nr. 46/2026 i KSHZ, e ka transformuar këtë kërkim në një pyetje krejt tjetër: nëse në korrik 2026 ekzistonte ende një dënim penal që prodhonte efekt ndalues. Duke bërë këtë, Komisioneri ka ngatërruar dy institute juridike të ndryshme: ndalimin material që buron nga lloji i dënimit dhe pasojën autonome që buron nga falsiteti i formularit.



Ky ngushtim nuk është thjesht një gabim formal. Ai ndryshon objektin e mosmarrëveshjes, shmang shqyrtimin e kërkesës reale dhe lë pa përgjigje faktin vendimtar se kandidatura u regjistrua dhe mandati u fitua mbi bazën e një dokumenti me të dhëna të pavërteta.

2. Dallimi thelbësor ndërmjet ndalimit material dhe deklarimit të rremë

Regjimi i parë lidhet me nenet 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 138/2015: nëse një dënim, masë sigurie ose rrethanë e caktuar e vendos personin në kushtet e moskandidimit apo mosushtimit të funksionit. Regjimi i dytë lidhet me nenin 5 të ligjit dhe me Vendimin e Kuvendit nr. 17/2016: detyrimin për deklarim të plotë e të vërtetë dhe pasojën e deklarimit të pavërtetë, të paplotë ose të pasaktë.

Kreu III, pika 3, shkronja “ç”, e Vendimit nr. 17/2016 parashikon se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta sjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi, zgjedhja, emërimi apo funksioni publik.

Kjo pasojë është e lidhur me integritetin dhe vërtetësinë e formularit. Ajo nuk kushtëzohet nga fakti nëse, vite më vonë, dënimi penal që provoi falsifikimin konsiderohet i paqenë për efekt të rehabilitimit penal.

3. Vendimi penal për falsifikimin është provë përfundimtare e faktit, jo shkak që mund të neutralizohet nga ekzekutimi i dënimit

GJKKO e ka deklaruar z. Hajdari fajtor pikërisht për falsifikimin e formularit. Ky vendim nuk krijoi falsitetin në vitin 2024; ai provoi përfundimisht një falsitet që ekzistonte në datën 02.04.2023, kur formulari u depozitua dhe u përdor për regjistrimin e kandidaturës.

Përfundimi i 150 orëve të punës në interes publik mund të prodhojë pasojat që ligji penal i njeh rehabilitimit. Por ai nuk shfuqizon vendimin gjyqësor, nuk e bën deklarimin e vitit 2023 të vërtetë, nuk korrigjon formularin, nuk legalizon retroaktivisht regjistrimin e kandidaturës dhe nuk zhduk avantazhin zgjedhor të përfutur nga fshehja e informacionit.

“I paqenë” për efekt të rehabilitimit penal nuk do të thotë “i pandodhur” për efekt të ligjshmërisë së procedurës zgjedhore.

4. Neni 63 i Kodit Penal është zbatuar jashtë fushës së tij

Komisioneri i ka dhënë nenit 63 të Kodit Penal një efekt të përgjithshëm, sikur përfundimi i dënimit alternativ të fshinte çdo pasojë juridike të faktit të kryer. Ky interpretim është i gabuar. Neni 63 rregullon efektet penale të dënimit alternativ; ai nuk rregullon vlefshmërinë e kandidimit, të formularit të vetëdeklarimit dhe të mandatit zgjedhor të fituar më parë.

Pranimi i arsytimit të Komisionerit do të sillte një pasojë absurde: personi që falsifikon formularin, fiton mandatin dhe më pas kryen dënimin për falsifikimin, do ta

ruante përfitimin e marrë nga vetë falsifikimi. Një interpretim i tillë bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, me qëllimin e ligjit të dekriminalizimit dhe me parimin se askush nuk mund të përfitojë nga paligjshmëria e vet.

5. Gjendja juridike duhet vlerësuar në momentin e kandidimit dhe të fitimit të mandatit

Për ligjshmërinë e kandidimit janë përcaktuese data e depozitimit të formularit, regjistrimi i kandidaturës, përfshirja në fletën e votimit dhe momenti i shpalljes së rezultatit. Në të gjitha këto momente, formulari përmbante përgjigje të pavërteta.

Fakti që falsifikimi u provua me vendim penal më vonë nuk e zhvendos në kohë shkeljen. Shkaku ekzistonte përpara zgjedhjeve; prova përfundimtare u sigurua pas tyre. Neni 10 i ligjit nr. 138/2015 parashikon pikërisht pasojat kur kushtet verifikohen në faza të ndryshme, përfshirë pas fillimit të ushtrimit të mandatit.

6. Shkelja e nenit 5 dhe nenit 10 të ligjit nr. 138/2015

Neni 5 përcakton detyrimin personal për plotësimin dhe nënshkrimin e formularit dhe parashikon se deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale. Neni 10 i ngarkon KQZ-së detyrimin të refuzojë kandidaturën, të heqë kandidatin, të shpallë pavlefshmërinë e zgjedhjeve ose të mandatit dhe, pas fillimit të mandatit, të shpallë pavlefshmërinë dhe përfundimin e parakohshëm të tij.

KQZ nuk po thirret të krijojë një ndalim të ri. Ajo po thirret të zbatojë pasojën që vetë ligji dhe akti normativ i Kuvendit kanë lidhur me paraqitjen e të dhënave të pavërteta.

7. Shkelja e nenit 6/1 të Kushtetutës dhe e qëllimit të ligjit të dekriminalizimit

Neni 6/1 i Kushtetutës ndalon zgjedhjen, emërimin ose ushtrimin e funksionit publik kur verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj. Ligji nr. 138/2015 ka si qëllim garantimin e besimit të publikut dhe mbrojtjen e mirëfunksionimit demokratik të organeve të zgjedhura.

Interpretimi i Komisionerit e zbraz këtë garanci kushtetuese: kandidati mund të gënjejë, të marrë pjesë në zgjedhje, të fitojë mandatin, të dënohet për falsifikimin dhe, pasi të kryejë dënimin alternativ, të mbajë përfitimin e marrë nga formulari i rremë. Ky rezultat është i papajtueshëm me nenin 6/1 dhe me frymën e ligjit.

8. Cenimi i zgjedhjeve të lira, të barabarta dhe të informuara

Sipas nenit 1 pika 3 të Kushtetutës, qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike. Liria e votës nuk është vetëm mungesa e presionit fizik; ajo presupozon që zgjedhësi të mos mashtrohet për të dhëna që ligji i ka konsideruar të domosdoshme për integritetin e kandidatit.

Fshehja e dënimit dhe e dëbimit i dha kandidatit një avantazh të padrejtë ndaj rivalit dhe privoi zgjedhësit nga mundësia për një zgjedhje të informuar. Diferenca e ngushtë e



votave e bën cenimin edhe më konkret, por pasoja juridike e formularit të rremë nuk varet nga prova hipotetike se sa zgjedhës do të kishin votuar ndryshe.

9. Precedenti Agim Kajmaku dhe ndryshimi i pajustificuar i praktikës së KQZ-së

Me vendimin nr. 1101, datë 01.11.2019, KQZ shqyrtoi rastin e Agim Kajmakut, Kryetar i Bashkisë Vorë. Edhe në atë rast, subjekti nuk përfshihej domosdoshmërisht në ndalimin material për shkak të përfundimit të procesit penal me pafajësi, por KQZ konstatoi se ai kishte mosdeklaruar hetimin, arrestimin, gjykimin dhe masa të tjera në Greqi.

KQZ zbatoi Kreun III, pika 3, shkronja "ç", të Vendimit nr. 17/2016 dhe shpalli pavlefshmërinë e përfundimit e parakohshëm të mandatit. Pra, vetë institucioni ka pranuar se deklarimi i rremë është një shkak autonom për largimin nga funksioni, edhe kur nuk ekziston më një dënim penal aktiv.

Rasti Hajdari është, në këtë aspekt, edhe më i rëndë: falsiteti i formularit është provuar me vendim penal të një gjykate shqiptare. Megjithatë, vendimi nr. 46/2026 arrin në rezultatin e kundërt, pa shpjeguar dallimet juridikisht relevante dhe pa u përballur me precedentin Kajmaku.

Elementi	Agim Kajmaku	Kreshnik Hajdari
Formular me përgjigje negative	Po	Po
Fakte të padeklaruara në Greqi	Hetim, arrestim, gjykim, masa	Dënim penal dhe dëbim
Dënim aktiv në momentin e vendimit të KQZ	Jo; ishte shpallur i pafajshëm	Komisioneri pretendon se dënimi është i pagënë
Falsifikim i provuar me vendim penal shqiptar	Jo në atë procedurë	Po, me vendim nr. 6/2024 të GJKKO-së
Pasojë e dhënë nga KQZ	Pavlefshmëri dhe përfundim mandati	Vazhdim mandati

10. Cenimi i sigurisë juridike, barazisë dhe detyrimit për arsyetim

Administrata mund të ndryshojë praktikën e saj, por vetëm duke dhënë arsye të posaçme, objektive dhe bindëse. Vendimi nr. 46/2026 citon rastin Qerim Ismailaj, që lidhet me efektet e rehabilitimit penal, por shmang precedentin Kajmaku, i cili lidhet drejtpërdrejt me mosdeklarimin dhe falsitetin e formularit.

Ky përzgjedhim selektiv i precedentëve cenon sigurinë juridike dhe parimin e trajtimit të barabartë. Ligji nuk mund të prodhojë për një kryetar bashkie humbjen e mandatit dhe për një tjetër vazhdimin e tij, kur elementi juridik përcaktues është i njëjtë ose më i rëndë.

11. Arsyetim i pamjaftueshëm dhe mosdhënie përgjigjeje ndaj pretendimeve thelbësore

Vendimi i ankimuar nuk jep përgjigje të plotë për: efektin autonom të deklarimit të rremë; formulimin "menjëherë dhe në çdo kohë" të Vendimit nr. 17/2016; faktin se



vendimi penal provon falsifikimin; gjendjen juridike në datën e kandidimit; precedentin Kajmaku; ndikimin në barazinë e garës dhe besimin e zgjedhësve.

Një akt administrativ që nuk përballlet me pretendimet vendimtare dhe provat kryesore është i mangët në arsyetim dhe i cenueshëm për shfuqizim.

12. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka zgjidhur themelin në favor të z. Hajdari

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, sepse procedura administrative nuk kishte përfunduar me një akt përfundimtar. Ai nuk ka vendosur se formulari ishte i vlefshëm, se falsifikimi nuk prodhonte pasoja ose se mandati duhej të vazhdonte.

Përkundrazi, vendimi konfirmon se KQZ ishte organi që duhej të shqyrtonte çështjen në themel. Vendimi nr. 46/2026 është pikërisht akti përfundimtar që tani i nënshtrohet kontrollit të plotë të KAS-it.

13. Hetimi administrativ duhet të jetë i plotë dhe KAS-i ka kompetencë të marrë prova kryesisht


KAS-i, sipas nenit 21 të Kodit Zgjedhor, shqyrton dhe zgjidh ankimet ndaj akteve të Komisionerit. Secili anëtar ka të drejtë të marrë kryesisht prova që ndodhen në administrim të KQZ-së. Për këtë arsye kërkohet administrimi i dosjes së plotë të vetëdeklarimit, vendimit grek, komunikimeve me Interpolin, vendimit penal të GJKKO-së, vërtetimit të formës së prerë dhe precedentit Kajmaku.

IV. VLERËSIMI KUSHTETUES DHE LIGJOR I DEKRIMINALIZIMIT

Dekriminalizimi nuk mund të reduktohet në një kontroll formal të certifikatës së gjendjes gjyqësore dhe as në verifikimin nëse një dënim vazhdon të prodhojë pasoja penale në momentin e vendimmarrjes. Ai përbën një mekanizëm kushtetues të posaçëm, të ngritur për të mbrojtur integritetin e funksioneve publike, ligjshmërinë e kandidimit dhe besimin e qytetarëve tek institucionet e zgjedhura. Në këtë kuptim, formulari i vetëdeklarimit nuk është një dokument dytësor apo thjesht procedural, por akti me të cilin kandidati merr përgjegjësi personale për saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e të dhënave që paraqet përpara KQZ-së dhe publikut.

Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë më me dyshime apo indicie. Ekzistenca e dënimit të huaj dhe mosdeklarimi i tij janë verifikuar, ndërsa falsifikimi i formularit është provuar me vendim penal. Megjithatë, vendimi i ankimuar shkëput në mënyrë artificiale dënimin penal nga pasoja zgjedhore e veprimit, duke u përqendruar vetëm te fakti se dënimi alternativ është ekzekutuar dhe konsiderohet i paqenë.

Një interpretim i tillë do të thotë se kandidati mund të fshehë të vërtetën, të regjistrohet, të marrë votat dhe mandatin, ndërsa zvarritja procedurale t'i shërbejë më pas si mbrojtje. Kjo e zbraz ligjin nga qëllimi i tij dhe shpërblen përfitimin e marrë nga paligjshmëria.



Pra, rehabilitimi penal mund të shuajë disa pasoja të dënimit, por nuk e bën të vërtetë formularin e rremë dhe nuk rehabiliton votën e marrë me informacion të fshehur.

V. KËRKESAT PËR PROVA

Përveç provave në dosjen ankimore apo dosjen që disponon KQZ, kërkojmë administrimin e dosjes së plotë administrative të formularit të vetëdeklarimit të z. Kreshnik Hajdari, përfshirë formularin origjinal të datës 02.04.2023, shkresën nr. 220, datë 04.04.2023, të Koalicionit "Bashkë Fitojmë", së bashku me provat e depozituara me të, si dhe vendimin penal të formës së prerë nr. 3286/23-6-1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë, të përkthyer dhe të legalizuar.

Po ashtu, kërkojmë administrimin e shkresës nr. 2931/6 prot., datë 19.07.2023, dhe të komunikimeve me Interpol Athinë lidhur me dënimin dhe dëbimin, vendimit nr. 6, datë 25.01.2024, të GJKKO-së, së bashku me vërtetimin e formës së prerë, si dhe aktit të SPAK nr. U38/7 prot., datë 25.04.2024, për përfundimin e ekzekutimit të dënimit alternativ.

Gjithashtu, kërkojmë të administrohen vendimet nr. 816/2023, nr. 1/2024 të KAS-it, nr. 35/2026, nr. 2/2026 të KAS-it dhe nr. 46/2026, vendimi nr. 349/2026 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 1101, datë 01.11.2019, i KQZ-së për z. Agim Kajmaku, së bashku me aktet e tjera të praktikës administrative të cituara në të, si dhe tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për Bashkinë Kuçovë dhe vendimi nr. 679, datë 04.07.2023, për dhënien e mandatit.

PËR SA MË SIPËR

KËRKOJMË NGA KAS

- i. **Pranimin e ankimit**
- ii. Shfuqizimin e plotë të vendimit nr. 46, datë 01.07.2026, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- iii. Ndryshimin e tij, duke konstatuar paraqitjen e të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta nga z. Kreshnik Riza Hajdari në formularin e vetëdeklarimit.
- iv. Konstatimin se ky deklaram i rremë e vendos subjektin në kushtet e përjashtimit të menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi, zgjedhja dhe funksioni publik.
- v. Shpalljen e pavlefshmërisë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të z. Kreshnik Riza Hajdari si Kryetar i Bashkisë Kuçovë.
- vi. Njoftimin e menjëhershëm të Kryeministrit dhe institucioneve kompetente.
- vii. Administrimin e të gjitha provave të kërkuara dhe zhvillimin e një hetimi administrativ të plotë.



- viii. Në mënyrë alternative, shfuqizimin e vendimit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim me detyra të detajuara, pa lejuar përsëritjen e ngushtimit të objektit vetëm te efektet aktuale të dënimit penal.

DOKUMENTET BASHKËLIDHUR

- a) Kopje e vendimit nr. 46, datë 01.07.2026.
- b) Kopje e vendimit nr. 1101/2019 për Agim Kajmakun.
- c) Dokumente të tjera sipas listës së provave.

Tiranë, më ____ / 07 / 2026

**ANKUESI
LEFTER MALIQI**

